



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për financat e pushtetit lokal Nr. 03/L-049 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKT - RREGULLORES PËR
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSAT KOMUNALE 15NR.434-
79235 E DATËS 20.12.2019

Neni 1

Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e Projektit të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale 15NR.434-79235 e datës 20.12.2019 në vazhdim të tekstit Komisioni, në përbërje si vijon:

1. Bekim Shabani , Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, Kryesues
2. Vlora Krasniqi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtare
4. Lumnije Ejupi, Sektori pronësor juridik, anëtare
5. Burim Gashi, Drejtorati për Administratë, anëtar
6. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
7. Jalldyze Gashi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe puna e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për financat e pushtetit lokal dhe dispozitat tjera ligjore të cilat i japin kompetencë Komunës caktimin e taksave, të pregadisë Projektin e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale më së largu deri me datën 31.01.2021 . Nëse rast ndryshimet dhe plotësimet përfshijnë disa nene të Rregullores, Komisioni të hartojë draftin e ri të Rregullores për taksat Komunale dhe pastaj konform dispozitave ligjore ta vë në diskutim publik 30 ditë . Projekt Rregullorja pas përfundimit të diskutimit publik dhe aprovimit final nga Kryetari Komunës të dërgohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 434-2200
Lipjan, më 11.01.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

